

VENDIM
Nr.367, datë 3.7.1995

PËR ADMINISTRIMIN E BURSIVE PËR STUDIME UNIVERSITARE, SHKOLLA TË MESME DHE PËR STUDIME, SPECIALIZIME E KUALIFIKIME PASUNIVERSITARE JASHTËSHETIT

Me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë ngakrohet me administrimin e bursave për studime universitare, shkolla të mesme dhe për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare jashtë shtetit .

Burimet e këtyre bursave janë:

a)Bursa që i ofrojnë vendit tonë shtete, organizata ndërkombëtare, institucione të ndryshme, fondacione etj. Të tilla bursa janë ato që përmbahen:

-në marrëdhëniet ose në programet periodike të nënshkruara në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë me qeveritë e vendeve të tjera dhe me organizata ndërkombëtare (marrëveshje kulturore, arsimore, tekniko-shkencore, ekonomike etj);

-në dokumente të tjera ku vendi ynë është palë;

-në njoftimet zyrtare që vijnë për qeverinë tonë.

Ministria e Punëve të Jashtme i dërgon Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë kopje të k[tyre marrëveshjeve, programeve, dokumente të tjera e njoftime zyrtare menjëherë pas nënshkrimit ose njoftimit të tyre.

b)Bursat që jep shteti ynë miratimi i të cilave, së bashku me fondin përkatës, bëhet çdo vit nga Këshilli i Ministrave, në bazë të propozimit të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

2.Komiteti i Shkencës dhe i teknologjisë, duke u mbështetur në programet e zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe duke bashkëpunuar me ministrinë, institucionet e tjera qendrore dhe me palët e huaja, përcakton fushat për studime universitare dhe për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare në përputhje me sasinë dhe llojshmërinë e bursave në dispozicion. Këto fusha, të ndara, sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, së bashku me të dhënat e nevojshme lidhur me kohëzgjatjen e bursave, me kriteret e pranimit të kandidatëve etj. Shpallen nga Komiteti i Shkencës dhe i teknologjisë me mjetet e informacionit dhe të shtypit për qëllime konkurrimi.

3.Kandidatët për studime universitare përzgjidhen nga Ministria e Arsimit. Si rregull ata përzgjidhen nga studentët e vitit të parë ose të dytë të degëve përkatëse ose të përafërta, si dhe nga nxënësit që kanë përfunduar maturën me medalje të artë. Në rastet kur ndonjë bursë nuk paraqiten kandidatë nga kategoritë e mësipërme, përzgjidhen kandidatë nga nxënës që kanë përfunduar maturën me rezultate shumë të mira. Ministria e Arsimit për çdo bursë përzgjedh 2-3 kandidatë dhe propozimet i dërgon në Komitetin e Shkencës dhe të teknologjisë, së bashku me të dhënat e nevojshme për çdo kandidat.

4.Kandidatët për studime, specializime dhe kualifikime pasuniversitare përzgjidhen nga ministrinë ose institucionet e tjera qendrore, të cilat krijojnë mundësi të barabartë konkurrimi të lirë për të gjithë specialistët.

Për këtë titullari i ministrisë ose i institucionit tjetër qendror formon një komision të veçantë për vlerësimin e kandidatëve që paraqitin kërkesën. Si rregull, pranohen kërkesat e kandidatëve që kanë punësuar në sektorin shtetëror ose privat të sistemit të Ministrisë ërkatëse. Në rast se për ndonjë bursë nuk ka kërkesa nga kandidatë të punësuar që plotësojnë kriteret, mund të shqyrtohen edhe kërkesa të kandidatëve cilësorë të papunësuar. Komisioni psdi studion dokumentet përkatëse të secilit konkurrues, përzgjedh 2-3 kandidatë për çdo bursë dhe ministria ose institucioni tjetër qendror propozimet i dërgon në Komitetin e Shkencës dhe të Teknologjisë, së bashku me të dhënat e nevojshme për çdo kandidat.,

5.Kandidatët e propozuar i nënshtrohen testimit të gjuhës që kërkon pala, e cila ofron bursa. Kur ky testim nuk kërkohet nga pala e huaj, testimi i gjuhës bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga

pala jonë.

6. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë krijon një komision të përbashkët me palën që ofron bursën. Në këtë komision pala shqiptare përfaqësohet nga Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe nga Ministria e Arsimit.

Në rast se pala e huaj nuk e praktikon formimin e këtij komisioni të përbashkët, atëherë krijohet një komision vetëm me përfaqësues nga dikasteret e palës sonë të cituar më lart.

Kryetari i komisionit të përbashkët për palën shqiptare apo i komisionit caktohet nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

7. Komisioni i përbashkët (apo komisioni), mbi bazën e të dhënave përkatëse të kandidatëve përcakton kandidatët fitues dhe në rrugë diplomatike i përcjell dokumentet e tyre në përfaqësitë e palëve që ofrojnë bursat.

8. Ministria e Punëve të Jashtme, duke bashkëpunuar me Komitetin e Shkencës dhe të teknologjisë dhe me ministrinë përkatëse, nëpërmjet përfaqësive a misioneve diplomatike të palëve në vendin tonë dhe përfaqësive e misioneve tona diplomatike jashtë shtetit, ndjek shfrytëzimin sasior të bursave dhe ecurinë e studimeve të kandidatëve fitues.

9. Trajtimet financiare që lidhen:

-me masën e bursës, kur ajo akordohet nga shteti ynë;

-me shtesën mbi bursat që ofrojnë palët e huaja, kur kjo gjykohet e ulët;

-me shpenzimet e udhëtimit të kandidatëve etj., përcaktohen me udhëzim të veçantë nga Ministria e Financave, Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

10. Ndërmjet punëdhënësit dhe kandidatit të punësuar që dërgohet jashtë shtetit për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare, nënshkruhet një kontratë me detyrime të ndërsjella:

a) Punëdhënësi i ruan kandidatit vendin e punës dhe gjatë kohës së studimit, specializimit a kualifikimit i jep familjes së tij një pjesë të pagës në masën e caktuar me dispozita të veçanta.

b) Kandidati detyrohet të kthehet në vendin e tij të punës dhe të punojë për një kohë që caktohet në kontratë për të vënë në jetë njohuritë e fituara. Në rast të kundërt, detyrohet të kthejë të gjitha shpenzimet e harxhuara.

11. Përdorimi i bursave që përmbahen në marrëveshje, protokolle, a dokumente të tjera të nënshkruara nga ministrinë, institucionet e tjera qendrore, universitare etj., me homologët e tyre në vende të tjera, si dhe i bursave që vijnë të adresuara prej burimesh të ndryshme, nga përdorimi i të cilave ministrinë, institucionit qendror, universitetit etj., u linden detyrime, të kryhen sipas dispozitave të këtij vendimi me të vetmin ndryshim që rolin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë ta kryejnë drejtuesit përkatës. Për përdorimin e këtyre bursave ministrinë, institucionet qendrore, universitetet etj., informojnë Komitetin e Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

12. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punëve të Jashtme hartojnë bashkërisht udhëzimet për procedurat dhe kriteret e shfrytëzimit sasior e cilësor të bursave për studime universitare dhe për studime, specializime e kualifikime pasuniversitare jashtë shtetit.

13. Kur dispozitat e këtij vendimi bien në kundërshtim me rregullat dhe kriteret që ka pala e huaj për dhënien e bursave, palët merren vesh ndërmjet tyre në rrugë diplomatike për mënyrat e shfrytëzimit të këtyre bursave.

14. Ministria e Punëve të Jashtme t'ua bëjë të njohur palëve të tjera përmbajtjen e këtij vendimi.

15. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.519, datë 10.12.1992 "Për administrimin e bursave të studimeve universitare e pasuniversitare dhe të veprimtarive të tjera kualifikuese jashtë shtetit", dhe nr.285, datë 14.6.1993 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.519, datë 10.12.1992", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi